

## NJOFTIM

Për kandidatët që do të vlersohen për pozicionin e punës :

### **Specialist i Zbatimit të Portabilitetit të Numrit –AKEP**

#### **Procedura: PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINE EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimit nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhen e provës dhe emerimin në kategorine ekzekutive”, i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se :

- **ZNJ. SUELA HAXHIJA** do të vazhdojë konkurimin, në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive;
- **ZNJ. BIA ÇERA** do të vazhdojë konkurimin, në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

#### **Konkurimi:**

Meqenëse data 04.06.2019 është zyrtarisht pushim për shkak të festës “Dita e Bajramit të Madh” bazuar në Kodin e Procedurave Administrative konkursi i planifikuar në datë 04.06.2019 do të shtyhet në ditën pasardhëse, më datë 05.06.2019, si më poshtë:

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **05.06.2019** ora **10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **05.06.2019** ora **12:00**.

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP**, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidateve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;
- b) për intervisten e strukturuar me goje, deri në **25 pikë**;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në **60 pike**;

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist i Zbatimit të Portabilitetit të Numrit**.

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV të Vendimit nr. 243, date 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **05.06.2019**.

**Njoftimi do të bëhet:** në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **06.06.2019**.

*Njesia Përgjegjëse*

*Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)*